



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 10-104-02-11940-26

Nr. i fq. / Br.str. / No.pg. 1-1

Data / Datum / Date 30.04.2026

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



DREJTORIA E ARSIMIT

Bazuar në nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 17 shkronja h të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 81 të Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.-I-34 datë 25.04.2016, në pikën 2.20 të nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore, vendimin i komisionit me nr.10-110-04-29376-24 datë 27.09.2024, Ftesën për Ofertë nr.prot.219 datë 22.04.2026 dhe raportin vlerësimit të ofertave të datës 30.04.2026, komisioni me datë 30.04.2026 merr këtë:

Vendim

I. Kompania "Ylberi Tours", me numër biznesi 810383464 dhe seli në Breznicë-Obiliq, përzgjidhet si fituese për organizimin e ekskursionit për maturantët e vitit shkollor 2025/26 të SHMLP "Ismail Dumoshi" dhe Gjimnazit "17 Shkurti" në Obiliq.

Arsyetim

SHMLP "Ismail Dumoshi" dhe Gjimnazi "17 Shkurti", më datë 22.04.2026, përmes Ftesës për Ofertë me nr. protokolli 219, kanë paraqitur kërkesë për dorëzimin e ofertave nga kompani të ndryshme për organizimin e ekskursionit për 144 nxënës (maturantë) në Shqipëri.

Komisioni, më datë 30.04.2026, ka bërë vlerësimin e ofertave, ku oferta në vlerë prej 110.00 e paraqitur nga kompania "Ylberi Tours" është shqyrtuar dhe vlerësuar si e rregullt. Pas analizimit të dokumentacionit, komisioni ka konstatuar se kjo kompani i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në shpallje (Rishpallje – Ftesë për Ofertë) dhe është në përputhje me kërkesat e vendosura nga organizatori.

Komisioni:

Urim Grajçevci - kryetar

Tahir Morina – anëtar

Besa Gashi Dvorani – anëtare

Qefsere Kastrati – anëtare

Valdete Brajshori – anëtare



Vendimi t'i dorëzohet:

- DA-së
- SHMLP "Ismail Dumoshi" dhe Gjimnazit "17 Shkurti" në Obiliq
- Anëtarëve të Komisionit- Kompanisë fituese
- Arkivit